

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mozaik prej 105 metrash katrorë në qytetin antik në Turqi
ADRESA	https://www.koha.net/kulture/mozaik-prej-105-metrash-katrore-ne-qytetin-antik-ne-turqi
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 01:47:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 07:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dcb1caac576275d008485701879759c5125dc940d5f8a59a05526bee43aa4e13
TEKSTI	2da09565f8f70e590b437c726b6f7610fabf947cacad5af1eb84d70d5cec65dc
PAMJA	b42b07ba01e9ea228a971e790010f4a3ac0b8f86146dccc768787d861253181

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d21d2db7fe9085897a0ff1c633633b9b9fd3db2efc7e294d628ef081b517419f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1e2948ee29ab13edbd442d93c043487a99670263e579192fb4ff737734c16e45
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d21d2db7fe9085897a0ff1c633633b9b9fd3db2efc7e294d628ef081b517419f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KULTURË

Mozaik prej 105 metrash katrorë në qytetin antik në Turqi



Mozaiku i shekullit IV i zbuluar në qendër të një bazilike në qytetin antik, Pompeiopolis

19 shtator 2026 09:01

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Pompeiopolis afër Detit të Zi në veri të Turqisë ka nxjerrë në pah një mozaik të shekullit IV. Pompeiopolisi ishte bërë seli peshkopale më së voni gjatë shekullit V, pra një vend ku ushtronte detyrën një peshkop i krishterë. Mozaiku i madh i përket pikërisht periudhës së këtij transformimi. Studiuesit theksojnë se 105 metrat katrorë të zbuluar deri tani ndoshta nuk përfaqësojnë sipërfaqen përfundimtare të tij. Një pjesë e dyshemesë ndodhet ende nën tokën e paeksploruar

Një mozaik i zbukuruar me motive gjeometrike, që daton në shekullin IV, është zbuluar në qendër të një bazilike, kërkimet arkeologjike të së cilës kanë nisur vetëm në vitin 2025.

Pompeiopolis ndodhet pranë qytetit të sotëm Taşköprü, në provincën Kastamonu, ndërsa rrënojat e qytetit antik shtrihen nën kodrën Zimbili Tepe në veri të Turqisë. Qyteti u themelua nga gjenerali romak, Gnej Pompeu i Madh, në vitin 64 ose 63 para Krishtit, pas fitores ndaj mbretit pontik, Mitridati VI. Pikërisht nga emri i Pompeut mori emrin edhe qyteti.

Bazilika që ndryshoi funksion

Veçmas interesante është historia e ndërtesës ku u gjet mozaiku. Sipas kërkimeve arkeologjike të deritanishme, faza e parë e ndërtimit të saj daton rreth viteve 150–160, në një periudhë kur Pompeiopolisi po përjetonte zhvillimin e tij më të madh. Shumë shekuj më vonë, ndërtesa mori një funksion të ri. Gjatë antikitetit të vonë, ajo u transformua dhe u përfshi në infrastrukturën e krishterë të qytetit. Pompeiopolisi ishte bërë seli peshkopale më së voni gjatë shekullit V, pra një vend ku ushtronte detyrën një peshkop i krishterë.

Mozaiku i madh i përket pikërisht periudhës së këtij transformimi. Studiuesit theksojnë se 105 metrat katrorë të

Showbiz.

"Animals" e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

Futboll.

Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Venezian

Futboll.

Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevilias

Shtojca për Kulturë.

Kur pikëllimi shndërrohet në krenari

Arbëri.

Kurti: Nevojitet strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit të Speciales

Basketboll.

Bora e nis edicionin e ri me fitore të thellë

zbuluar deri tani ndoshta nuk përfaqësojnë sipërfaqen përfundimtare të tij. Një pjesë e dyshemesë ndodhet ende nën tokën e paeksploruar. Për këtë arsye, para vazhimit të gërmimeve, vëmendje e veçantë po i kushtohet dokumentimit dhe konservimit të pjesës së mozaikut që tashmë është zbuluar.

Edhe



Kulturë • 9 sht 2026

Hapen mozaikët që kthejnë kohën në Romën Antike



Gjatë kërkimeve të këtij viti u zbulua edhe një objekt tjetër interesant – një kokë mermeri e Erosit, perëndisë greke të dashurisë, që daton në gjysmën e dytë të shekullit II

Koka e Erosit në një bazilikë të krishterë

Gjatë kërkimeve të këtij viti u zbulua edhe një objekt tjetër interesant – një kokë mermeri e Erosit, perëndisë greke të dashurisë, që daton në gjysmën e dytë të shekullit II. Skulptura u gjet në pastoforium, një dhomë anësore pranë hapësirës së altarit të kishës së hershme të krishterë. Kjo do të thotë se ajo ishte krijuar më shumë se një shekull përpara se ndërtesa të merrte funksionin e saj të krishterë.

Ky zbulim ofron një vështrim interesant mbi mënyrën se si objektet dhe ndërtesat e vjetra u përshtatën me praktikën e reja fetare. Ndryshimi i funksionit të një ndërtese nuk nënkuptonte domosdoshmërisht shkatërrimin e materialeve të mëparshme. Disa objekte mund të ishin hequr nga konteksti i tyre fillestar dhe të ishin ruajtur ose ripërdorur.

Koka e Erosit përfaqëson kështu një lloj lidhjeje midis periudhës së mëparshme romake të qytetit dhe fazës së tij të krishterë në antikitetin e vonë.

Qyteti i fshehur

Pompeiopolisi është shumë më tepër se vetëm një bazilikë. Studimet gjeofizike të kryera që në vitin 2005 treguan se nën sipërfaqe ndodhen rrënojat e një qyteti të tërë antik. Gjatë kërkimeve janë identifikuar rrugë, ndërtesa publike dhe dy teatro.

Njëri prej teatrove ka ruajtur pjesë të ulëseve prej mermeri dhe një fasadë skenike të dekoruar, ndërsa një mbishkrim tregon se ai është ndërtuar rreth vitit 150.

Edhe



Kulturë • 22 kor 2026

Arkeologët në Turqi zbulojnë pishinën antike me standarde olimpike

Në këtë lokalitet po studiohet gjithashtu një domus i madh romak. Ky kompleks banimi zë rreth 2 mijë e 550 metra katrorë dhe është organizuar rreth një oborri qendror me peristil. Në disa dhoma janë zbuluar dysheme luksoze të realizuara me opus sectile, si dhe mbetje të sistemit të ngrohjes nën dysheme, të njohur si hypocaustum.

Kërkimet arkeologjike në Pompeiopolis kanë vazhduar që prej vitit 2006. Gërmimet e këtij viti janë përqendruar veçanërisht në bazilikën në akropol dhe në vazhdimin e konservimit të mozaikut në vilën romake.

#MOZAIK

#TURQIA

#POMPEIOPOLIS

Artikuj të ngjashëm



Kulturë • 30 pri 2026
Monumenti dy mijë vjet i vjetër i Athinës – artefakt i jashtëzakonshëm



Kulturë • 8 pri 2026
Arkeologët në Izrael gjejnë “fishekun” dy mijë e 500 vjet të vjetër me mesazh brutal

Kulturë • 1 pri 2026
Zbulohen prova për përdorim të “mitralozit antik” në rrethimin e Pompeit

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.